



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2329 Prot.

Tiranë, më 19.07.2023

V E N D I M

Nr. 2

**“PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE PËR KANDIDATË QË PËRFAQËSOJNË
SHOQËRINE CIVILE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Në mbështetje të neneve 55 dhe 153, të ligjit nr. 115/2016, datë 03.11.2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 16, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”:

V E N D O S A:

1. Të shpallë një vend vakant për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe një vend vakant për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga anëtarët e organizatave të shoqërisë civile.
2. Shpallja e vendeve vakante dhe kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët sipas nenit 54 dhe 152 të ligjit nr.115/2016, për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONCAJ

